



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

BANKA E SHQIPËRISË

Nr. _____ Prot.

Nr. 1659 Prot.

17.03.2020

URDHËR

Në bazë dhe për zbatim të nenit 102, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 12, shkronja "a", neni 53, pika 4; Statutit të Bankës së Shqipërisë miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 90, datë 2.12.2015, neni 11, pika 6; Kryeministri i Shqipërisë dhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë urdhërojnë:

- 1) Të shtyhet afati i pagimit të kësteve të kredive për biznese dhe individë deri në datën 31.05.2020, për të gjithë ata kredimarrës, të cilët janë përballur me vështirësi në këtë periudhë si pasojë e COVID-19;
- 2) Kredimarrësit duhet të komunikojnë me kredidhënësit (banka, institucione financiare jobanka apo me shoqëritë e kursim-kredive) duke u argumentuar këtyre të fundit arsyet mbi nevojat e tyre për shtyrje të pagimit të kësteve;
- 3) Institucionet e kreditimit do të bëjnë procesimin e çdo kërkesë të paraqitur pranë tyre brenda 3 ditëve nga data e marrjes së kërkesës;
- 4) Me zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjitha institucionet e kreditimit të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Edi Rama

Kryeministër

Gent Selko

Guvernator

